



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Kuvendi Komunal Dragash/Skuptina Opštine
Dragaš/Dragas Municipality

Ne bazë të nenit 2,4, 10 pika 2,13,14,15 dhe 16 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.03/L-049, nenit 12 pika c të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.03/L-040 dhe nenit 32.2 të Statutit të Komunës së Dragashit, Rekomandimit të Komisionit të Përbashkët të Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për mbikëqyrjen e ligjëshmerisë së akteve të komunave, Kuvendi I komunës së Dragashit, në seancën e vetë të mbajtur më 26.09.2013, miraton këtë:

ANEKS-RREGULLORE

MBI NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES MBI LARTËSINË E TAKSAVE , NGARKESAVE DHE GJOBAVE KOMUNALE

Neni 1

1.1 Në nenin 10 paragrafi 10.3 të Rregullores mbi lartësinë e taksave ,ngarkesave dhe gjobave komunale nr.01-06-793/1 prej 29.05.2013 teksti “Me gjobë prej 100,00 deri 200,00 euro do të denohet për kundervajtje personi juridik ose fizik nëse pa leje të organit kompetent kryen veprime në kundërshtim me veprimet e percaktuara në tarifën 10 të kësaj Rregullore” fëshihet

Neni 2

2.1. Te Drejtorati për Ekonomi ,Financa dhe Zhvillim tarifa nr.4 teksti “Ngarkesat për marrjen e lejeve për ushtrimin e veprimtarive afariste dhe shërbime profesionale janë përcaktuar me Rregullore të veçantë e percaktuar sipas nenit 10 dhe 11 të Ligjit mbi Financat e Pushtetit Lokal” fëshihet

Neni 3

3.1. Tarifa nr.5 Transferi i pronës me numrat tarifor 5.1.1, deri 5.1.3 fëshihet .

Neni 4

4.1. Te Drejtorati për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Inspektion tarifa nr.8 me numrat tarifor 8.1.1 deri 8.1.12 fshihet

Neni 5

5.1. Numri Tarifor 9.1.44 I tarifës nr.9 të Drejtorati për Urbanizim, Katasër dhe Mbrojtje të Mjedisit fshihet.

Neni 6

6.1. Numri tarifor 11.1.8 i tarifës nr.11 fshihet

Neni 7

7.1. Kjo Rregullore hyn në fuqi 8 ditë pas aprovimit në Kuvend.

Dragash, 26.09.2013
01 Nr.1477/3



KRYESUESI I KUVENDIT
Shaban Shabani